



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**Njoftim për Shtyp**

**Për përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 75.006% të aksioneve të Bankës Popullore nga shoqëria Societe General S.A**

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e tij të datës 21.06.2007, shqyrtoi çështjen me objekt: Njoftimi për përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 75.006 % të aksioneve të Bankës Popullore nga shoqëria Societe General S.A.

Transaksioni i njoftuar konsiston në shitblerjen e 75.006% të kapitalit dhe të të drejtës së votës, të barasvlershme me 11.056 aksione të Bankës Popullore. Në përfundim të këtij transaksioni, Societe General do të zotërojë 75.006% të aksioneve të Bankës Popullore, ndërsa pjesa prej 24.99% të aksioneve të mbetura të kapitalit aksionar do të zotërohen nga 9 aksionerët e saj.

**Vlerësimi i impaktit në konkurrencë**

Transaksioni i shitblerjes së aksioneve të Bankës Popullore në favor të aksionerit\shoqërisë Societe General S.A, nuk ndryshon strukturën e tregut bankar.Ky ndryshim lidhet vetëm me ndryshimin e strukturës brenda B.P.

Nga analiza post-përqëndrimit, vërehet se tregu është i hapur për konkurrencë, pa barrierra hyrëse dhe karakterizohet nga prania e konkurrentëve të fortë, me pjesë tregu të konsiderueshme dhe konkretisht në tregun e depozitave, bonove të thesarit, kredive etj

Palët pjesmarrëse në përqëndrim ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregje të veçanta gjeografike dhe nuk kanë klientë të përbashkët. Në këtë kontekst përqëndrimi nuk mund të ketë efekte antikonkurruese duke qënë se në kuptimin e nenit 13, pika 1 e Ligjit, nuk rrezikon të krijojë ose të forcojë pozitën dominuese të ndërmarrjeve të përfshira në përqëndrim.

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” , Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë, përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së pjesës së 75.006% të aksioneve të Bankës Popullore në Shqipëri nga Societe General, me qendër në Paris, Francë.